
ORIENTUES PËR TË FILLUAR SHPEJT

Synimet për Studim të Përditshëm të Shkrimeve të Shenjta



CILAT JANË TË REJAT PËR KËTË VIT

Duke filluar nga data 1 janar 2021, studentët e seminarit që dëshirojnë kredite për kursin, do të nevojitet të lexojnë në librin e shkrimit të shenjtë për kursin e studimit të paktën 75 përqind të ditëve kalendarike të semestrit (shih "Pritshmëritë për Leximin e Shkrimeve të Shenjta për Përfundimin e Kursit dhe Diplomimin" te Manuali për Rregulloren). Mësuesit mund t'i ndihmojnë studentët ta arrijnë këtë duke i përkrahur ata në vendosjen dhe mbajtjen e synimeve për studim të përditshëm të shkrimeve të shenjta.



VLERA E STUDIMIT TË PËRDITSHËM TË SHKRIMEVE TË SHENJTA

Presidenti Rasëll M. Nelson dha mësim: "Teksa kërkojmë të jemi dishepuj të Jezu Krishtit, përpjekjet tona që ta dëgjojmë Atë nevojitet të jenë përherë e më të qëllimshme. Kërkon përpjekje të ndërgjegjshme dhe të vazhdueshme që ta mbushim jetën tonë të përditshme me fjalët e Tij, mësimet e Tij, të vërtetat e Tij. . . . Zhytja e përditshme në fjalën e Perëndisë është jetike për mbijetesën tonë shpirtërore, veçanërisht në këto ditë të rrëmujës në rritje. Teksa ushqehemi me bollëk përditë me fjalët e Krishtit, fjalët e Krishtit do të na thonë se si të reagojmë ndaj vështirësive me të cilat kurrë nuk menduam se do të përballëshim" ("Dëgjojeni Atë", konferenca e përgjithshme e prillit 2020).



SI MUND T'I NDIHMONI STUDENTËT TUAJ

Mësuesit mund t'i ndihmojnë studentët duke krijuar përvoja nxënieje domethënëse me shkrimet e shenjta në çdo orë mësimore të klasës. Në fillim të çdo semestri, mësuesit duhet të sigurojnë kohë që studentët të diskutojnë mbi vlerën e studimit të shkrimeve të shenjta dhe aftësinë e tij për t'i ndihmuar ata që të afrohen më pranë Shpëtimtarit të tyre, Jezu Krishtit. Studentët duhet të nxiten që të vendosin vetë synimet e tyre për studimin e përditshëm të shkrimeve të shenjta.

Mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm për t'i ndihmuar studentët të përmbushin synimet e tyre të studimit të përditshëm vetjak të shkrimeve të shenjta. Mësuesit mund ta përmbushin këtë rol në shumë mënyra, përfshirë:

- Duke përdorur shkrimet e shenjta dhe mësimet nga profetët bashkëkohorë që t'i ndihmojnë studentët ta kuptojnë rëndësinë e studimit të përditshëm të shkrimeve të shenjta për vetë dishepullimin dhe kthimin e tyre në besim te Jezu Krishti.
- Duke i ndihmuar studentët që të vendosin synime të studimit të përditshëm të shkrimeve të shenjta që janë me vend, domethënëse dhe të përshtatura me nevojat dhe aftësitë e tyre.
- Duke i njohur studentët dhe duke ndjekur rregullisht ecurinë në përvojat e tyre me studimin vetjak të shkrimeve të shenjta.
- Duke siguruar mundësi të rregullta në orën mësimore për studentët që të dëshmojnë për atë që po mësojnë dhe ndiejnë për Jezu Krishtin dhe ungjillin e Tij gjatë studimit të tyre vetjak të shkrimeve të shenjta.

- Duke i ndihmuar vazhdimisht studentët që të jenë përgjegjës nëpërmjet krijimit të mundësive në orën mësimore që studentët të ndjekin ecurinë e studimit të tyre vetjak të shkrimeve të shenjta në programin kompjuterik mySeminary [Seminarilm] ose metodë tjetër regjistrimi.
- Duke i ndihmuar studentët në një mënyrë që i nxit ata ta përfundojnë pjesën e mbetur për lexim nga shkrimi i shenjtë nëse kanë zbritur poshtë masës 75 përqind.



BURIMET NË DISPOZICION PËR MËSUESIT

- Të gjithë mësuesit duhet të trajnohen nga udhëheqësi i tyre profesional nëpërmjet një përvoje profesionale apo diskutimi mujor. Përshtatjet vendore për këtë trajnim duhet të bëhen duke u këshilluar me drejtorin rajonal.
- Sugjerimet për t'i ndihmuar studentët të regjistrojnë dhe ndjekin ecurinë e leximit të përditshëm të shkrimeve të shenjta nga ana e tyre te programi kompjuterik mySeminary [Seminarilm], mund të gjenden te <https://web.microsoftstream.com/channel/8600711f-29ec-40c8-99d2-c1240a7204ec>.
- Përshtatjet vendore mund të bëhen në zonat ku programi kompjuterik mySeminary [Seminarilm] nuk është në dispozicion.
- Parimet që gjenden te pjesa “Detyra për Shlyerje” e manualit për rregulloren, duhet të zbatohen kur ndihmoni një student/e që ka zbritur poshtë masës 75 përqind të leximit të shkrimeve të shenjta. Shembuj të detyrave për shlyerje të leximit të shkrimeve të shenjta mund të gjenden në përvijimin e përvojës profesionale të përmendur më lart.

